



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë TeleDoc Holding GmbH nga shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.196 Prot., i AK, datë 09.04.2021 “Njoftim mbi përqendrimin”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë TeleDoc Holding GmbH nga shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH.

Më datë 11 mars 2021, Asambleja e jashtëzakonshme e ortakëve të shoqërisë TeleDoc Holding GmbH, ka bërë një ndryshim në statutin e shoqërisë.

TeleDoc Holding GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionin Austriak, me seli në Vienë, Austri, me objekt veprimtarie ndërmjetësimin e konsultave mjekësore përmes telefonit dhe videos, ndihma mjekësore me telefon dhe video.

TeleDoc Holding GmbH zotërohet nga Z. Mag Christian Brandstetter, nga Blue Rock Capital GmbH, nga Z. Florian Brandstetter dhe nga Viveca Beteiligungen GmbH.

TeleDoc Holding GmbH operon në Shqipëri përmes filialit të zotëruar indirekt prej tij TeleDoc Albania SHPK, e cila ka si objekt veprimtarie ofrimin e konsulencës mjekësore, nëpërmjet bashkëbisedimit me video dhe telefon me klientët, ofrimin e trajnimeve përmes internetit, ofrimin e specialiteteve mjekësore për vizita dhe konsulta mjekësore, pediatri, ortopedi, kardiologji etj

Viveca Beteiligungen GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionin Austriak, me seli në Vienë, Austri, me objekt veprimtarie blerjen, mbajtjen, menaxhimin dhe shitjen e pasurive të paluajtshme, sidomos pjesëmarrja në ndërmarrje dhe shoqëri të tjera.

Viveca Beteiligungen GmbH nuk kryen veprimtari në Shqipëri por realizon të ardhura nëpërmjet shoqërive të kontrolluara nga Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe.

Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe ka kontroll direkt mbi shoqëritë Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group SHA dhe Intersig Vienna Insurance Group SHA dhe kontroll indirekt mbi shoqërinë VIG Services Shqipëri SHPK.

Ndryshimi në statutin e shoqërisë TeleDoc Holding GmbH përcakton se shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH do të ketë një të drejtë absolute të vetos kur shoqëria të kalojë rezoluta për çështje, transaksione dhe masa dhe/ose për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.